



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna Drenas/Glllogoc

Zyra e Personelit

01 Nr. MA-21127 dt. 19.06/2020

Bazuar në nenin 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe në Ligjin Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, Komuna Drenas/Glllogoc, Zyra e Personelit shpallë:

**KONKURS PUBLIK ME
MARRËVESHJE PËR SHËRBIME TË VEÇANTA**

Për angazhim afatshkurter konform nenit 12 paragrafit 4, të Ligjit Nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, (Marrëveshje për Shërbime të Veçanta).

Titulli i vendit të punës:

koefficienti :

I. Zyrtar i Depos 1- Drejtoria Komunale e Arsimit

6

Detyrat e punës

Zyrtar i Depos 1- Një (1) pozitë

1. Regjistron në E-pasuri asetet për 29 shkolla, 2 shkolla të mesme, qerdhes dhe DKA- së;
2. Regjistron në E-pasuri inventarin e të gjitha shkollave fillore, shkollave të mesme, qerdhes dhe DKA-së;
3. Në E-pasuri regjistron projektet e bankes botërore, donacione për të gjitha shkollat fillore, dy të mesme dhe qerdhes;
4. Bënë regjistrimin në E-pasuri të teknologjisë informative të të gjitha shkollave, qerdhes dhe DKA-së;
5. Regjistron në E-pasuri secilin artikull të kërkesave: mirëmbajtja e ndërtesave, material higjenik, furnizim me material shpenzues, derivate për gjenerator për të gjitha shkollat;
6. Përgaditë raportë mujor për E-pasuri.

Kualifikimi i nevojshëm arsimor,(aftësitë, përvoja si dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës)

- Fakulteti Ekonomik;
- Diplomë universitare, pa përvojë pune ose shkollë të lartë 2 vite përvojë profesionale;
- Kandidati duhet të ketë shkathtësi komunikuese;
- Njohja e programeve për punë (Word, Excel, Power Point etj).

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077, Për Marrëdhëniet e Detyrimeve.
Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtuar e rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur 8 (tetë) ditë kalendarike, 19/06/2020 deri më 26/06/2020, nga data në tabelën e shpalljes në hyrje të komunës dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kohëzgjatja e angazhimeve është 5.5 muaj.

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues si dhe e-mail adresën. Vetëm kandidatët nga lista e ngushtë do të kontaktohen për intervistë. Dokumentet e pakompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Vendi ku mund të merren dhe të dorëzohen aplikacionet:

Në objektin e komunës, kati i parë sporteli nr.10 -12, gjatë orarit të punës.

Aplikacionit i bashkangjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikim arsimor dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme për këtë vend pune, për të cilin konkurohet.



ZYRA E PERSONELIT